



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

Lënda: Kthim përgjigje

E nderuar

Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 3 dhjetor 2024 “Kërkesë për informacion” në lidhje me dekorin në Bashkinë Shkodër ju informojmë:

1. Sa është buxheti i parashikuar në bashkinë tuaj për dekore dhe organizime festash?

Bashkia Shkodër ka realizuar shpenzimet për dekorin për vitin 2024 bazuar në buxhetin e miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak si më poshtë: - “Blerje aksesorë dekori për festat e fundvitit” me vlerë 5,870,000 lekë - “Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjatë vitit” me vlerë 355,000 lekë

2. Sa ka shpenzuar bashkia juaj për dekoret e festave të 28-29 nëntorit?

Shpenzimet e dekorit për festat e 28-29 Nëntorit janë pjesë e objektit “Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjatë vitit” ku janë të përfshira edhe materiale për festat e tjera dhe aktivitete të ndryshme të bashkisë. Punimet për realizimin e dekorit realizohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike me kapacitetet teknike dhe punonjësit e saj.

3. Sa ka shpenzuar bashkia juaj për dekoret e festave të fundvitit?

Shpenzimet e dekorit për festat e fundvitit janë 5,870,000 lekë më TVSH.

4. Cila është procedura e ndjekur për të kryer këto punime?

Blerjet e aksesorëve të dekorit për festat e fundvitit realizohen me procedurë prokurimi ndërsa punimet për realizimin e dekorit realizohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike me kapacitetet teknike dhe punonjësit e saj të sektorit të ndriçimit e dekorit.

5. A ka pasur kontraktorë apo nënkontraktorë që kanë kryer këto punime?

Nuk ka kontraktorë apo nënkontraktorë që kanë kryer këto punime pasi realizohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike.

6. Nëse po, cilët janë ata dhe cila është procedura e ndjekur?

Janë realizuar vetëm procedurat e prokurimit për: -Blerje aksesorë dekori për festat e fundvitit - Blerje materiale të ndryshme për dekorim gjatë vitit.

Ju falenderuar për mirëkuptimin